



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 1362/Prot.

Tiranë, më 02.05.2025

VENDIM

Nr. 102, datë 23.05.2025

PËR

**“PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS
SË KANDIDATES PËR MAGJISTRAT PROKUROR, E CILA MUND TË
DIPLOMOHET NGA SHKOLLA E MAGJISTRATURËS NË VITIN 2025,
ZNJ. ENKELANA SHALA”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë me pjesëmarrjen e:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar (në mungesë)
6. Ledina RIZA	Anëtar (në mungesë)
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.05.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 e vijues, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

***“Përfundimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatës për magistrat
prokuror, e cila mund të diplomohet nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2025,
znj. Enkelana Shala”***

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 1362 prot., datë 20.05.2025, të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, me relator z. Olger Eminaj, si dhe referuar bazës ligjore të sipërpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,



V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*në vijim Këshilli*) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale (*në vijim Komisioni*), në mbështetje të neneve 32, pika 2-6 dhe nenit 35, pika 1, germa “c”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 171, dt. 27.09.2019, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, e ndryshuar, të Këshillit (*në vijim Rregullorja*) ka ndjekur veprimet procedurale për verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatës për magjistrat prokuror, znj. Enkelana Shala, e cila mund të diplomohet nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2025.
3. Me Vendimin nr. 24, datë 13.02.2025 “Për fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës për magjistratë prokurorë, të cilët do të diplomohen nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2025”, Këshilli ka filluar procedurën administrative për verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatët prokurorë të cilët do të diplomohen nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2025.
4. Me Vendimin nr. 25, datë 13.02.2025, “Për hedhjen e shortit për caktimin e relatorit për verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatët për magjistratë prokurorë, të cilët do të diplomohen nga Shkolla e Magjistraturës, në vitin akademik 2025”, Këshilli zhvilloi procedurën e hedhjes së shortit për caktimin e relatorit për secilin kandidat.
5. Relatori për kandidaten Enkelana Shala u caktua z. Olger Eminaj. Në zbatim të pikës 1, të Seksionit A, të Kreut VI, të Rregullores, në rrugë elektronike (*me e-mail*) në datë 18.02.2025, Relatori ka njoftuar kandidaten për fillimin e procedurës së verifikimit, si dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit, apo ndonjë anëtar i Këshillit, në rast të ekzistencës së një situate konflikti interesi.
6. Njëkohësisht, kandidatës i janë dërguar formularët përkatës sipas kërkesave të ligjit duke i kërkuar plotësimin dhe dorëzimin e tyre së bashku me Autorizimet për verifikim pranë çdo personi fizik ose juridik, publik ose privat, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të të dhënave personale që lidhen me verifikimin e figurës dhe pasurisë, si dhe përpunimin e këtyre të dhënave kudo ku ato janë të regjistruara nga ana e Këshillit.
7. Në datë 24.02.2025, protokolluar me nr. 346 prot., kandidatja Enkelana Shala ka depozituar pranë Këshillit dokumentet si më poshtë:

1. Autorizimi për Këshillit të Lartë të Prokurorisë me qëllim sigurimin dhe verifikimin e të dhënave personale;
2. Deklaratë me të dhënat mbi adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktet telefonike për njoftim gjatë kësaj procedure;



3. Deklaratë mbi papajtueshmërinë me funksionin e magjistratit për shkak të anëtarësisë në parti politike;
 4. Deklaratë Individuale që kandidati nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve sekrete;
 5. Formular Vetëdeklarimi për zbatimin e Ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
8. Në mbështetje të nenit 35, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe gremës "b", Kreu II, dhe Seksionit B, Kreu VI, të Rregullores, relatori ka ndjekur veprimet proceduriale për verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidates Enkelana Shala.
9. Pas verifikimeve paraprake dhe përgjigjeve të ardhura nga institucionet përgjegjëse shtetërore, më poshtë paraqiten gjetjet përfundimtare për kandidaten që pritet për t'u emëruar magjistrat (*profili prokuror*):

a) Verifikimi i pasurisë së kandidatit

10. Me shkresën nr. 849 prot., datë 13.03.2025, Këshilli i është drejtuar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim ILDKPKI*), për verifikimin e pasurisë për kandidaten për magjistrat, e cila do të diplomohet në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2025, znj. Enkelana Shala.
11. Nga ana e këtij institucioni, është kthyer përgjigja me shkresën nr. 88/23 prot., datë 24.04.2025. ILDKPKI-ja ka paraqitur aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në sistemin e drejtësisë, për kandidaten për magjistrat, e cila do të diplomohet në Shkollën e Magjistraturës, zonjën Enkelana Shala.
12. Në këtë akt përfundimtar për subjektin deklarues kandidaten Enkelana Shala theksohet se:
- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
 - b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
 - c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - ç) nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

13. Ky Akt-Kontrolli përfshin periudhën deri në datë 26.06.2022.

14. Në datë 12.03.2025, kandidatja Enkelana Shala ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së, Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë që kandidon për t'u emëruar magjistrate, profili Prokuror.



15. Për kryerjen e kontrollit të plotë të kësaj deklarate, ILDKPKI-ja ka krahasuar Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e drejtësisë dhe dokumentacionin justifikues bankar dhe jo-bankar, të dorëzuar nga vetë kandidata me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës pranë institucioneve si: Banka e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë, institucioneve të tjera financiare, institucioneve shtetërore si, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve (DPT), Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), Qendra Kombëtare të Biznesit (QKB), Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD), Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), Drejtoria e Përgjithshme Detare (DPD). Ky kontroll kryhet për periudhën 28.06.2022 - 12.03.2025.
16. Në mënyrë të përmbledhur, referuar të dhënave të Deklaratës së pasurisë dhe interesave private rezulton se, kandidata Enkelana Shala ka deklaruar deri në datë 09.03.2025, si më poshtë:
1. Apartament me sip. totale 104.5 m², Njësia Administrative nr. 7, Tiranë. Vlera 73 150.0 euro.
Kandidatja zotëron 100%;
 2. Llogari rrjedhëse në Raiffeisen Bank. Vlera 662 987 lekë. Kandidatja zotëron 100%;
 3. Llogari credit card në Raiffeisen Bank. Vlera 600 euro. Kandidatja zotëron 100%;
 4. Detyrim ndaj shoqërisë “Alba Ceramika N” Sh.p.k., për blerje apartamenti. Vlera 2 000 euro;
 5. Kredi bankare në Raiffeisen Bank, detyrimit i mbetur në vlerën 3 561 704 lekë. Kandidatja zotëron 100%.
17. Vlera e pasurisë e deklaruar bruto është në shumën rreth 662 987 lekë + 73 150 euro, e konvertuar rreth 7 925 000 lekë dhe neto rreth 4 164 000 lekë.
18. Kandidatja ka detyrime financiare ndaj shoqërisë së ndërtimit në shumën 2 000 euro, dhe ndaj RFZ Bank për kredinë, në shumën rreth 3 561 704 lekë.
19. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera në përputhje me Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik” i ndryshuar, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, për kandidaten Enkelana Shala është konstatuar se:
- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
 - b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
 - c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - e) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.



20. Me shkresën nr. 853 prot., datë 13.03.2025, Këshilli i është drejtuar Agjencisë së Inteligjencës Financiare (AIF) me kërkesë për informacion nëse, kandidatja Enkelana Shala ka kryer transaksione apo disponon pasuri të dyshimta. Nëse po, është kërkuar të na dërgohen të dhënat si dhe dokumentacioni përkatës.
21. Në përgjigjen shkresore drejtuar Këshillit informohet se: *“Pas kërkimeve në sistemin elektronik, për kandidaten znj. Enkelana Shala nuk disponohen të dhëna për transaksione apo pasuri të dyshimta”*.
22. Me shkresën nr. 851 prot., datë 13.03.2025, Këshilli i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) me kërkesë për informacion nëse, kandidatja Enkelana Shala rezulton të jetë regjistruar si subjekt tregtar. Nëse po, është kërkuar të informohet Këshilli në lidhje me:
- Të ardhurat e realizuara nga subjekti përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar aktivitetin, duke na dhënë informacion të saktë, lidhur me fitimin neto, për çdo vit të ushtrimit të aktivitetit;
 - Të na vihet në dispozicion kopje e pasqyrave financiare dhe deklaratave të Tatimit të Thjeshtuar mbi Tatimin, TAPBV, apo të Tatim Fitimit, të dorëzuara nga subjekti, për periudhën nga fillimi i aktivitetit deri më sot.
23. Me shkresën nr. 4476/1 prot., datë 25.03.2025, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), informohet se: *“Shtetasja znj. Enkelana Shala nuk figuron e regjistruar në organet tatimore për ushtrim aktiviteti privat si person fizik ose juridik”*.
24. Me shkresën me nr. 852 prot., datë 13.03.2025, Këshilli i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD) me kërkesë për informacion nëse, kandidatja Enkelana Shala ka kryer veprime importi, eksporti apo kalimi tranzit të mallrave nga/në territorin e Republikës së Shqipërisë. Nëse po, është kërkuar të na dërgohen të dhënat si dhe dokumentacioni përkatës.
25. Me shkresën nr. 5371/1 prot., datë 21.03.2025, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) ka informuar se, nga verifikimet e kryera në sistemin elektronik të administrimit të të dhënave “Asycuda World” ka rezultuar që, shtetasja Enkelana Shala *“nuk ka kryer ndonjë veprim doganor import-eksporti. Gjithashtu, nuk rezultojnë deklaratime të bëra për para CASH, çek, apo metale a sende të çmuara në pikat e kalimit kufitar doganor për periudhën Mars 2004 deri më 08 Mars 2025”*.
26. Me shkresën nr. 850 prot., datë 13.03.2025, Këshilli i është drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH) me kërkesë për informacion mbi të ardhurat bruto dhe neto të realizuara çdo muaj, sipas të dhënave që disponon për shtetasen Enkelana Shala.
27. Me shkresën nr. 3245 prot, datë 25.03.2025, të ISSH, është dërguar informacion i cili disponon të dhëna për kontributet të cilat mblidhen dhe dërgohen nga drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet Webservice sipas formularit standard përkatës



(formulari përmban të dhëna për pagën dhe derdhjen e kontributit të sigurimeve shëndetësore për periudhën Qershor 2022 - Tetor 2022).

28. Me shkresën nr. 843 prot., datë 13.03.2025, Këshilli i është drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) me kërkesë për informacion nëse kandidatja Enkelana Shala rezulton e regjistruar si subjekt tregtar.
29. Me shkresën nr. 5555/1 prot., datë 21.03.2025, të QKB-së, është dërguar informacion se shtetasja Enkelana Shala nuk figuron të jetë pajisur me NIPT, si person fizik, juridik apo të zotërojë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë Regjistrat Tregtar.
30. Nga përgjigjet e ardhura nga këto institucione arrihet në përfundimin se, ka rezultuar përputhshmëri mes deklarimeve të kandidatit të kontrolluar, Aktit të përgatitur nga ILDKPKI-ja, si dhe përgjigjeve të ardhura nga institucionet e mësipërme.
31. Në këtë mënyrë, konkludohet se, nuk ka nevojë të kryhet hetim më i thelluar se ai i kryer nga ILDKPKI-ja.

b) Verifikimi i figurës së kandidatit

32. Mbi bazën e Formularit të Vetëdeklarimit për zbatimin e Ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për kandidaten Enkelana Shala rezulton se:

- nuk ka qenë e dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj;
- nuk është e dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- nuk ka qenë ndonjëherë nën hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një veprë penale;
- nuk është e dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- nuk ka qenë ndonjëherë nën hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një veprë penale;
- nuk ka qenë e ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një veprë penale;
- nuk është caktuar ndaj saj ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo;
- nuk është lëshuar ndonjëherë ndaj saj një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale;
- nuk është marrë ndaj saj masa e dëbimit nga një shtet i huaj;
- nuk ka jetuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.



33. Me shkresën nr. 848 prot., datë 13.03.2025, Këshilli i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorive pranë gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke kërkuar informacion nëse, për kandidaten Enkelana Shala ka patur:

- Të dhëna apo indicje të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime të ngritura në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, përfshirë drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta;
- Të dhëna për kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht, ose persona të dyshuar për kryerjen e një veprë penale) ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike;
- Materiale kallëzuese të mosfilluara, procedime penale të pushuara, pezulluara apo të dërguara për gjykim, ku kallëzimi ka qenë në ngarkim të këtij shtetasi.

34. Me shkresën nr. 438/3 prot., datë 27.03.2025, Prokuroria e Përgjithshme informon si më poshtë:

“Nga verifikimet në sektorin e protokoll arkivit sekret rezultoi se, në emër të shtetases Enkelana Shala “nuk disponohen të dhëna apo indicje që çënojnë figurën e kandidates. Gjithashtu rezultoi se nuk ka çështje penale, kallëzim apo ankesa ndaj saj”.

35. Me shkresën nr. 10171 prot., (DB), datë 25.03.2025, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në përgjigje të shkresës nr. 845 prot, datë 13.03.2025. të Këshillit, konfirmon se:

“Pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale të kësaj prokurorie, nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal në emër të shtetases Enkelana Shala, për periudhën 01.07.2022 deri aktualisht”.

36. Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Berat, Gjirokastrë, Dibër, Tiranë, Durrës, Korçë, Fier, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Lezhë, Kukës, Sarandë, në përgjigje të shkresave të dërguara nga Këshilli, informojnë se:

“Për shtetasen Enkelana Shala nuk disponojnë të dhëna, apo indicje të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese, të dhëna për kontakte me persona të papërshtatshëm, apo materiale kallëzuese të mosfilluara, procedime penale të pushuara, pezulluara apo të dërguara për gjykim”.

37. Me shkresën nr. 838 prot., datë 13.03.2025, Këshilli i është drejtuar Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke kërkuar informacion nëse, për kandidaten Enkelana Shala ka patur në ngarkim çështje penale, urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje të menjëhershëm.

38. Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me shkresën nr. 6066/1 prot., datë 11.03.2025, dhe Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Gjirokastrë, Dibër, Tiranë, Durrës, Korçë, Fier, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Lezhë, Kukës, Sarandë, në përgjigje të shkresave të dërguara nga Këshilli informojnë se:

“Për shtetasen Enkelana Shala nuk rezultojnë çështje penale, urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje të menjëhershëm”.

39. Me shkresën nr. 844 prot., datë 13.03.2025, Këshilli i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke kërkuar informacion nëse, për kandidaten Enkelana Shala ka patur apo ka në ngarkim çështje penale në gjykim.

40. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me shkresën nr. 502/1 prot., datë 18.03.2025 dhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me shkresën nr. 1111/3 prot., datë 01.04.2025, informojnë se:

“Për shtetasen Enkelana Shala nuk rezultojnë të ketë proces gjyqësor penal në ngarkim dhe kjo gjykate nuk ka dhënë ndonjë vendim penal”.

41. Gjatë procedurës së verifikimit të figurës për kandidaten Enkelana Shala iu kërkuar informacion shërbimeve informative si: Shërbimit Informativ Shtetëror (shkresa nr. 846 prot., datë 13.03.2025), Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pranë Ministrisë së Brendshme (shkresa nr. 847 prot., datë 13.03.2025), Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, pranë Ministrisë së Mbrojtjes (shkresa nr. 839 prot., datë 13.03.2025), Byrosë Kombëtare të Hetimit (shkresa nr. 841 prot., datë 13.03.2025) nëse, për kandidaten Enkelana Shala disponohen:

- Të dhëna apo indicje për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta;
- Të dhëna për kontakte me persona të papërshtatshëm (lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” i ndryshuar ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike;
- Të dhëna për kontakte me persona të papërshtatshëm (persona të dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndryshuar) ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike.

42. Me shkresat e dërguara nga Shërbimi Informativ Shtetëror, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, pranë Ministrisë së Brendshme, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, pranë Ministrisë së Mbrojtjes dhe Byroja Kombëtare e Hetimit, për kandidaten Enkelana Shala, informohet se:

- Nuk disponohen të dhëna për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme,
- Nuk ka të dhëna për veprimtari kriminale apo të ketë lidhje/kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar,
- Nuk disponohen të dhëna/informacione për përfshirjen e tij në veprimtari që çenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.

43. Referuar Deklaratës së datë 18.03.2025, mbi papajtueshmërinë me funksionin e magjistratit për shkak të anëtarësisë në parti politike, kandidatja Enkelana Shala ka deklaruar se, nuk është anëtar në ndonjë parti politike, pasi kjo përbën shkak papajtueshmërie me funksionin e magjistratit. Kjo deklaratë është lëshuar me përgjegjësi ligjore sipas nenit 6 të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

44. Me shkresën nr. 842 prot., datë 13.03.2025, Këshilli i është drejtuar Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, duke kërkuar verifikimin e figurës për kandidaten Enkelana Shala.

45. Me Shkresën nr. 2132 prot., datë 15.04.2025, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka informuar se:

“nuk disponohen të dhëna për përfshirjen e zonjës Enkelana Shala në veprimtari që çenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme”.

46. Me shkresën nr. 840 prot., datë 13.03.2025, Këshilli i është drejtuar Shkollës së Magjistraturës, duke kërkuar nëse kandidatja Enkelana Shala ka patur masë disiplinore.

47. Me shkresën nr. 421/1 prot, datë 21.04.2025, Shkolla e Magjistraturës informon se, kandidatja Enkelana Shala *nuk ka masë disiplinore në fuqi dhe ndaj saj nuk ka ndonjë proces disiplinor.*

48. Raporti paraprak i vlerësimit iu dërgua për njohje në rrugë elektronike kandidates në datë 13.05.2025, e cila në përgjigjen e saj në datë 14.05.2025, shprehu dakortësinë pa vërejte në lidhje me gjetjet e Raportit.

Për sa më sipër Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

49. Vlerëson të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidates për magjistrat prokuror që mund të diplomohet nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2025.



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës, nenet 159 dhe 189 pika 1 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 32 dhe 35, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidates për magjistrat prokuror, e cila mund të diplomohet nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2025, znj. Enkelana Shala.
2. Lejimin e kandidates Enkelana Shala, të vijojë me procedurat e mëtejshme për emërimin e saj si prokuror.
3. Të njoftohet për këtë vendim kandidatja Enkelana Shala dhe Shkolla e Magjistraturës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 23.05.2025.



KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Erion Fejzulla

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Olger Eminaj

ZV/KRYETAR
Erind Germenji

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Erind Merkuri